



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të bazë të nenit 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L- 149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr.04/L-077, për Marëdhënjet e Detyrimeve, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve bënë:

**Shpallje e konkursit publik
Për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta**

1. Emri i Institucionit:	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
2. Titulli i Vendit të Punës:	Zyrtar i Lartë për Regjistrim dhe Certifikim të PP-ve
3. Numri i referencës:	KQZ-34/2020
5. Grada e Vendit të Punës:	NP – G6 / K – 13.5
6. Lloji i kontratës :	Me kohë të caktuar
9. Raporton tek:	Drejtori i ZRPPC
10.Vendndodhja:	Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Koordinon aktivitetet në funksionim të implementimit të Certifikimit të SP dhe kandidatëve të tyre;
2. Koordinon takimet me përfaqësuesit e autorizuar të subjekteve politike si dhe realizon tërheqjen e shortit që përcakton rendin e kandidatëve në fletëvotim;
3. Ndihmon dhe përgatitë draft raporte dhe rekomandimet për KQZ-në;
4. Koordinon me institucionet tjera lidhur me ankesat e SP-ve dhe ligjshmërinë e kandidatëve dhe vëzhguesit e procesit zgjedhor;
5. Kujdeset dhe ruan të dhënat konfidenciale të kandidatëve;
6. Detyra tjera që i caktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:

1. Diplomë Universitare në drejtësi, shkencat politike ose administratë publike
2. Së paku katër vite (4) përvojë pune;
3. Aftësi dhe gatishmëri për të punuar me njerëz të përkatësive të ndryshme kulturore dhe etnike;
4. Njohje të mirë të dokumenteve juridike bazë (kushtetutave, ligjeve dhe rregulloreve të zgjedhjeve);
5. Përvojë në hartimin e procedurave;
6. Njohje të teknologjisë informative (MS Word,MS Excel dhe MS Access);
7. Njohja e gjuhës tjetër zyrtare e dëshirueshme;
8. Njohja e gjuhës angleze me gojë dhe me shkrim (e dëshirueshme).

Procedura e konkurimit

Formularët për punësim mund të merren në zyrën e personelit apo në webfaqen e KQZ-së, në linkun www.kqz-ks.org.
Formularët për punësim dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me konkurs, në zyrën e personelit në SKQZ, Rruga "Migjeni, nr. 21. 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, përmes postës me anë të shërbimit postar.

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura dhe, Certifikatë (dëshminë) që s'është nën hetime.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe inkurajon aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, si dhe pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listë të ngushtë do të kontaktohen.

Afati i aplikimit është i hapur tetë (8) ditë nga dita e publikimit, nga data 19.05.2020 deri me 26.05.2020.

Për informata shtesë ju lutem kontaktoni në numrin e telefonit 038-200-23-557.